

## BASHKIA KOLONJË

### FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

*Data: 22/ 08/ 2016*

**Për: Alb Garden Sh.p.k**

**Adresa:** Lezhë Lagjia Skënderbeg ,godinë private 1 katëshe në superstradën Lezhë-Shkodër km 1

**Procedura e prokurimit:** Procedura e Hapur “PUNË” me mjete elektronike .

**Përshkrim i shkurtër i kontratës:** Gjelbërimi i mjediseve publike të Bashkisë Kolonjë, qyteti Ersekë

**Burimi i financimit:** Vënë në dispozicion nga Buxheti i shtetit me vendim të Komitetit të Zhvillimit të Rajoneve nr.24, datë. 18.04.2016 për shpërndarjen e financimit për projektet e grandit: “ Reabilitimin mjedisor, gjelbërim dhe pyllëzim ”, Programi i zhvillimit të infrastrukturës vendore dhe rajonale, shtylla e I, për vitin 2016.

**Fondi limit pa TVSH: 35 000 000 ( Tridhjetëpesëmilion ) lekë pa Tvsh.**

Vlera e Financimit viti 2016      **35 000 000      lekë pa Tvsh**

**Afati për realizimin e shërbimit: 5 ( Pesë ) MUAJ nga nënshkrimi i kontratës .**

**Publikime të mëparshme:** Buletini i Njoftimeve Publike DATA 20/06/2016 NR.24

**Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:** çmimi më i ulët Xoferta ekonomikisht më e favorshme

**Data e zhvillimit të tenderit/Hapja e ofertave:** 11 / 07 /2016, ora 11 : 00

**Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:**

**1.Operatori ekonomik Alb Garden ShpkK 37513520 N**

*Emri i plotë i shoqërisë      numri i NUIS-it*

Vlera e ofertës 33 895

264 (Tridhjetë tremilionet e qindënëntë dhjetë pesë mijë e dyqind e jashtë dhjetë e katër) lekë pa Tvsh.

*(me numra dhe fjalë)*

**2.Bashkimi i Operatorë ekonomik DU & KO Shpk&Hera Pubic Service shpk**

*numri i NUISK 38207309 WNUISL61801508 E*

Vlera e ofertës 32 919 727 (Tridhjetë e dy milion e nëntë qind e nëntëmbëdhjetë mijë e shtatë qind e njëzet e shtatë) lekë pa Tvsh.

*(me numra dhe fjalë)*

**3. Bashkimi i Operatorë ekonomik KAJMAKU Shpk&HASTOCIshpk**  
**numri i NUISK 83725201 GNUISJ62028009 B**

Vlera e ofertës **33 298 740** (Tridhejtë tremilionedeqindenëntëdhjetëe tetë mijëeshtatëqindedyzetë) lekë pa Tvsh.

(me numra dhe fjalë)

**4. Operatori ekonomik KAJMAKU ShpkK 83725201 G**

Emri i plotë i shoqërisë numri i NUIS-it

Vlera **0 ( Zero )** lekë pa Tvsh.

(me numra dhe fjalë)

**Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:**

**1. Bashkimi i Operatorë ekonomik DU & KO Shpk&Hera Pubic Service shpk**

**2. Bashkimi i Operatorë ekonomik KAJMAKU Shpk&HASTOCIshpk**

**3. Operatori ekonomik KAJMAKU ShpkK 83725201 G**

\* \* \*

**Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:**

**1. Bashkimi i operatorëve ekonomik DU & KO Shpk & Hera Public Service shpk**

**a.** Vlera e ofertës të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomik **DU & KO Shpk & Hera Public Service shpk 32.919.727**

(Tridhejtëdymilionenëntëqindenëntëmbëdhjetëmijëeshtatëqindenjëzetëeshtatë) lekë pa tvsh është paraqitur **me gabime** aritmetike në vlera.

Nga përlllogaritjet e preventivit të dorëzuar bashkëngjitur ofertës shuma totale e preventivit është **31.960.900 lekë pa tvsh dhe 38.353.080 lekë me tvsh.**

**Shuma absolute e të gjitha korigjimeve është 2% më e ulët se vlera së ofertës ekonomike të ofruar sipas shtojcës 1.**

**b.** Në kriteret e përgjithshme të pranimit/ kualifikimit **pika 3, gërma a dhe b**, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomik duhet të dorëzojë dokumentet si më poshtë :

**-Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;**

**-Prokura e posaçme.**

Dokumentacioni (**marrëveshja e noterizuar**) i dorëzuar nga ky bashkim operatorësh ekonomik është i **pasaktë dhe i parregullt.**

**Objekti i prokurimit është** Gjelbërimi i mjediseve publike të Bashkisë Kolonjë,qyteti Ersekë dhe **JO**

**Shërbimi i gjelbërimit në Bashkinë Kolonjë** siç thuhet në dokumentin e paraqitur. Pjesëmarrja nga ky bashkim operatorësh ekonomik është ndarë vetëm në % pa përcaktuar **elementët konkretë** që do të kryejë secili nga antarët e këtij bashkimi .

**-Prokura e posaçme** e dorëzuar nga ky bashkim operatorësh ekonomik identifikon përfaqësues subjektin **Alko-Impex General Construction** .

c.Në kriteret e veçanta të kualifikimit **pika 1,germa ( d ) dhe (dh)** kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë dokumentet si më poshtë :

**- Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve sipas Shtojcës 9**

Dokumentacioni i paraqitur nga ky bashkim operatorësh ekonomik është i pafirmosur nga subjekti **Hera Public Service shpk** .

**-Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri**

Operatori ekonomik **DU & KO Shpk** vërtetimin e lëshuar nga OSHEE nuk e ka ne emer te operatorit ekonomik njëkohësisht nuk figuron dhe numër kontrate.

Pra, vërtetimi i lëshuar nga OSHEE nuk konfirmon shlyerjen e detyrimeve te operatorit ekonomik **DU & KO Shpk** .

d.Në kriteret e veçanta të kualifikimit, **pika 2.1**, kapaciteti ligjor kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë dokumentet si më poshtë :

**Ofertuesi duhet të tregojë se nga ana ligjore është në gjendje të realizojë objektin e prokurimit.**

**Objekti i Prokurimit duhet të jetë i pasqyruar në ekstraktin e gjendjes aktuale të shoqërisë, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, në objektin e veprimtarisë së operatorit ekonomik.**

-Operatori Ekonomik **Hera Public Service shpk** veprimtarinë e saj nuk e ka sipas objektit që është prokuruar,kjo e verifikuar nëpërmjet ekstraktit Historik të QKB.

**dh.** Në kriteret e veçanta të kualifikimit, **pika 2.2,germa a** kapaciteti ekonomik dhe financiar kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë dokumentet si më poshtë :

**Kopje të çertifikuara të bilanceve të tre viteve të fundit ushtrimore (2013,2014,2015),të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse dhe të konfirmuara nga Drejtoria përkatëse e Tatimeve.**

-Pasqyrat financiare të subjektit **DU & KO shpk** për **tre viteve të fundit ushtrimore (2013,2014,2015)** , janë të pakonfirmuara nga drejtoria rajonale e tatimeve Tiranë .

e. Në kriteret e veçanta të kualifikimit, **pika 2.3 -1** kapaciteti teknik kandidati /ofertuesi për sa i përket aftësisë teknike duhet të dorëzojë dokumentet si më poshtë :

*Pune të ngjashme , per nje objekt te vetem me vlere jo me te vogel se 17 500 000 (Shtatëmbëdhjetë milionepesëqindmijë ) leke pa t.v.shtë realizuar gjatë tre viteve të fundit;*

*ose*

*Pune të ngjashme, ku vlera monetare totale e puneve te kryera te marra se bashku gjate tre viteve të fundit është jo me e vogel se 70 000 000 ( Shtatëdhjetë milion) lekepa t.v.sh*

Subjekti **DU & KO** shpk ka paraqitur kontratë me datë 19.07.2013 lidhur me komunën Katund i Ri me objekt : Gjelbërimi i objekteve në territorin e komunës Katund i Ri me vlerë **18.656.856 lekë pa tvsh.**

Pas verifikimeve në faqen e app.gov.al në buletinin e datës.17 / 12 /2012 rezultoi se kontrata e lidhur midis palëve është në vlerën **1.990.190 lekë pa Tvsh.**

Për me tej ky subjekt ekonomik rezulton të ketë dorëzuar dokumentacion **të rremë.**

Subjekti **Hera Public Service shpk** ka paraqitur kontratë me datë K/27/2013 lidhur me Ministrinë e Infrastrukturës me objekt : Mirëmbajtje verore dhe dimërore e rrugëve nacionale dhe gjelbërimi i rrugëve –2012-2013 - Regjioni i Gjilanit B me vlerë **1.065.369.55euro.** Përsa i përket aftësisë teknike , bashkimi i operatorëve ekonomik nuk i përmbush kërkesat e vendosura nga Autoriteti Kontraktor .

f. Në kriteret e veçanta të kualifikimit, **pika 2.4 – 1,gërma b** kapaciteti profesional kandidati /ofertuesi për sa i përket aftësisë profesionale duhet të dorëzojë dokumentet si më poshtë :

**Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me leje , Kodi III.1.A të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçencimit (QKL) për ushtrim e aktivitetit objekt i prokurimit, (e vlefshme).**

Dokumentacioni i paraqitur nga subjekti DU & KO Liçensa me kod.III.1A është **e pavlefshme** pasi emërtimi përshkrues i veprimtarisë është Lejë mjedisore e tipit C për aktivitetin:Kryerja e shërbimit për pastrimin e territorit të Bashkisë Prrrenjas dhe largimit publik i mbeturinave në vendgroposje/grumbullimi i mbetjeve urbane deri në 1 ton në ditë .

g. Në kriteret e veçanta të kualifikimit, **pika 2.4-1,gërma c** kapaciteti profesional kandidati /ofertuesi për sa i përket aftësisë profesionale duhet të dorëzojë dokumentet si më poshtë :  
**Licence,Kodi III.2.B ,per “ Veprimtarite e tjera profesionale lidhur me ndikimin ne mjedis. lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçencimit (QKL) për ushtrim e aktivitetit objekt i prokurimit, (e vlefshme).**

Dokumentacioni i paraqitur nga subjekti DU & KO Liçensa me kod.III.2B është **e pavlefshme** pasi emërtimi përshkrues i veprimtarisë është Grumbullim ,transport ruajtje dhe asgjësim i mbetjeve plastike,metalike dhe qelqi .

gj. Në kriteret e veçanta të kualifikimit, **pika 2.4-2,** kapaciteti profesional kandidati /ofertuesi për sa i përket aftësisë profesionale duhet të dorëzojë dokumentet si më poshtë :

*Kandidati /ofertuesi duhet te percaktoje me ane te nje deklarate me shkrim (nga administratori i shoqerise) drejtuesin teknik (inxhinieri pyjesh i pajisur me certifikate per “Sherbime profesionale per projekttime.Sherbime profesionale per zbatime” leshuar nga Ministria e Mjedisit ) te punimeve ne objekt te deklaroje se ai do te jete i pranishem gjate te gjithe kohes qe do te kryhen punimet ne objekt,shoqeruar me dokumentacionin e meposhtem:*

- a. *Diploma*
- b. *CV*
- c. *Kontrate pune te vlefshme*

Në dokumentacionin e paraqitur **mungojnë** :

**1-**Çertifikata për “ Shërbime profesionale për projekttime.Shërbime profesionale për zbatime” lëshuar nga Ministria e Mjedisit.

**2-**Kontrata e Punës

**m.** Në kriteret e veçanta të kualifikimit, **pika 2.4- 3** kapaciteti profesional kandidati /ofertuesi për sa i përket aftësisë profesionale duhet të paraqesë certifikatat per ushtrim te aktivitetit **objekt i prokurimit:**

- a. Certifikaten per menaxhimin e cilesise se punimeve ISO 9001-2008
- b. Certifikate per menaxhimin e mjedisit ISO 14001-2004
- c. Certifikate per menaxhimin e shendetit dhe sigurimit ne pune OHSAS-18001
- d. Certifikate per menaxhimin e sigurise rrugore ISO 39001 – 2012
- e. Certifikate per system menaxherial te integruar Pas 99:2012

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë certifikatat ISO) (e vlefshme).

Dokumentacioni i paraqitur nga bashkimi i operatorve ekonomik, konkretisht **çertifikatat ISO** nuk janë të vlefshme pasi aktiviteti i tyre nuk është objekt i prokurimit .

Sa më sipër Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika3 dhe 5,të Ligjit Nr.9643,datë 20.11.2006,“Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII, Neni 66 pika 3, e shpall **të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

**2.**Bashkimi i operatorëve ekonomik **Kajmaku Shpk & Hastoçi shpk**

**a.** Në kriteret e veçanta të kualifikimit, **pika 2.2,gërma a** kapaciteti ekonomik dhe financiar kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë dokumentet si më poshtë :

***Kopje të çertifikuara të bilanceve të tre viteve të fundit ushtrimore (2013,2014,2015),të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse dhe të konfirmuara nga Drejtoria përkatëse e Tatimeve.***

-Pasqyrat financiare të subjektit **Kajmaku Shpk** për **tre viteve të fundit ushtrimore (2013,2014,2015)** , janë të pakonfirmuara nga drejtoria rajonale e tatimeve Durrës .

**b.** Në kriteret e veçanta të kualifikimit, **pika 2.3-1** kapaciteti teknik kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë dokumentet si më poshtë :



*Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:*

a. *Pune të ngjashme , per nje objekt te vetem me vlere jo me te vogel se 17 500 000 (Shtatëmbëdhjetë milionë pesëqind mijë ) leke pa t.v.sh të realizuar gjatë tre viteve të fundit;*

*Ose*

b. *Pune të ngjashme, ku vlera monetare totale e puneve te kryera te marra se bashku gjate tre viteve të fundit është jo me e vogel se 70 000 000 ( Shtatëdhjetë milion) leke pa t.v.sh*

*Eksperienca në punë të ngjashme duhet të përfshijë punë në hidrombjellje.*

*Vlerësimi i përvojës së suksesshme të operatorit ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:*

*Kopje kontrate*

*Aktin e kolaudimit,*

*Situacion Përfundimtar*

*Fatura tatimore te deklarimit te objektit ne organet tatimore*

*Formular vlersimi (sipas shtojces 8)*

*Çertifikate fitosanitare & origjine (per bimet dekorative).*

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga bashkimi i operatorëve ekonomik subjekti **Kajmaku Shpk** për kontratën e ngjashme me objekt: “**Gjelbërmi në Qytet**” mungojnë dokumentet si mëposhtë :

- 1-Eksperienc pune në hidrombjellje
- 2-Akti i Kolaudimit
- 3-Çertifikate fitosanitare & origjine (për bimet dekorative) .

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga bashkimi i operatorëve ekonomik subjekti **Kajmaku Shpk** për kontratën e ngjashme me objekt: “**Rehabilitimi i gjelbërimit anësor në rrugën IKV-Surrel dhe rreth rrotullimi Shkozë**” mungojnë dokumentet si mëposhtë :

- 1-Eksperienc pune në hidrombjellje
- 2-Akti i Kolaudimit
- 3-Situacion Përfundimtar
- 4-Çertifikate fitosanitare & origjine (për bimet dekorative) .

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga bashkimi i operatorëve ekonomik subjekti **Hastoçi shpk** ka dorëzuar kontratat si më poshtë :

- Ndërtim i shkollës 9-vjeçare Xhafzotaj Durrës
- Ndërtim i shkollës 9-vjeçare Romanat Durrës
- Ndërtim i shkollës së mesme Shote Galica, Bashkia Fush-Krujë

Kontratat e dorëzuara nuk janë të ngjashme me objektin që prokurohet dhe për këtë arsye nuk vërtetohet eksperiencia në punë e subjektit **Hastoçi shpk**.

c.Në kriteret e veçanta të kualifikimit, **pika 2.4-1**, kapaciteti profesional kandidati /ofertuesi për sa i përket aftësisë profesionale duhet të dorëzojë dokumentet si më poshtë :

*Licence,Kodi II.4 ,per “Prodhimi dhe/ose tregtimi i farnave dhe/ose fidaneve”*,leshuar nga QKL, (e vlefshme).

*Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me leje , Kodi III.1.A të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçencimit (QKL) për ushtrim e aktivitetit objekt i prokurimit, (e vlefshme).*

*Licence,Kodi III.2.B ,per “ Veprimtarite e tjera profesionale lidhur me ndikimin ne mjedis. lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçencimit (QKL) për ushtrim e aktivitetit objekt i prokurimit, (e vlefshme).*

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga bashkimi i operatorëve ekonomik subjekti **Kajmaku Shpk**nuk ka paraqitur dokumentet si mëposhtë :

*-Licence,Kodi III.1.A të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçencimit (QKL) për ushtrim e aktivitetit objekt i prokurimit.*

*-Licence,Kodi III.2.B ,per “ Veprimtarite e tjera profesionale lidhur me ndikimin ne mjedis. lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçencimit (QKL) për ushtrim e aktivitetit objekt i prokurimit.*

Nga verifikimi në faqen online të Qendrës Kombëtare të Liçesimit tek lista e licensave të lëshuara nga QKL në linkun <http://www.qkl.gov.al/RegistriesInsideNLC.asp>. rezulton se subjekti **Kajmaku Shpk**nuk është i liçensuar për **Kodin III.1.A dhe III.2.B** siç është kërkuar në dokumentet standarte të tenderit..

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga bashkimi i operatorëve ekonomik subjekti **Hastoçi shpk**nuk ka paraqitur dokumentet si mëposhtë :

*-Licence,Kodi II.4 ,per “Prodhimi dhe/ose tregtimi i farnave dhe/ose fidaneve”*,leshuar nga QKL.

*-Licence,Kodi III.1.A të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçencimit (QKL) për ushtrim e aktivitetit objekt i prokurimit.*

*-Ndërsa Licenca me Kodi III.2.B e dorëzuar nga subjekti **Hastoçi shpk**“ Për Veprimtarite e tjera profesionale lidhur me ndikimin ne mjedis. lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçencimit (QKL), është e pavlefshmepasi emërtimi përshkrues i veprimtarisë është Grumbullim ,ruajtje , transportim të mbetjeve urbane,kjo në kundërshtim me kërkesat e vendosura në dokumentet standarte të tenderit .*

Nga verifikimi në faqen online të Qendrës Kombëtare të Liçesimit tek lista e licensave të lëshuara nga QKL në linkun <http://www.qkl.gov.al/RegistriesInsideNLC.asp>. rezulton se subjekti **Hastoçi shpk**nuk është i liçensuar për **Kodi II.4 , Kodin III.1.A dhe III.2.B** siç është kërkuar në dokumentet standarte të tenderit.

d.Në kriteret e veçanta të kualifikimit, **pika 2.4-1, gërma e** ,kapaciteti profesional kandidati /ofertuesi për sa i përket aftësisë profesionale duhet të dorëzojë dokumentet si më poshtë :

***Çertifikate fitosanitare & origjine (per bimet dekorative).***

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga bashkimi i operatorëve rezultoi se dokumenti *çertifikate fitosanitare & origjine (per bimet dekorative)*, **mungon.**

**e.** Në kriteret e veçanta të kualifikimit, **pika 2.4-2**, kapaciteti profesional kandidati /ofertuesi për sa i përket aftësisë profesionale duhet të dorëzojë dokumentet si më poshtë :

Per efekt te kryerjes se puneve ne teresi operatori ekonomik duhet te kete stafin e meposhtem teknik Vertetuara me diplome, kontrate pune dhe cv.

- a.** 2(dy) inxh.agronom,
- b.** 1 (nje) inxh. Topograf,
- c.** 1(nje) inxh.mjedisi.

-Kontratat e punës me inxh.Agronom z.Ali Balliu është **e pavlefshme** pasi kontrata është lidhur për një periudhë 1 vjeçare dhe ka përfunduar në datën 02.06.2015.

-Kontratat e punës me inxh.Agronom z.Sadik Zela është **e pavlefshme** pasi kontrata është lidhur për një periudhë 1 vjeçare dhe ka përfunduar në datën 02.06.2015.

-Kontratat e punës me z.Florjan Tereziu është **e pavlefshme** pasi kontrata është lidhur për një periudhë 1 vjeçare dhe ka përfunduar në datën 02.06.2015.

-Kontratat e punës me inxh.Agromjedisi znj.Sagita Guçe është **e pavlefshme** pasi kontrata është lidhur për një periudhë 1 vjeçare dhe ka përfunduar në datën 08.06.2015.

**f.** Në kriteret e veçanta të kualifikimit, **pika 2.4-3**, kapaciteti profesional kandidati /ofertuesi për sa i përket aftësisë profesionale duhet të dorëzojë dokumentet si më poshtë :

**Kandidati/ofertuesi të paraqesë certifikatat per ushtrim te aktivitetit objekt i prokurimit:**

- a. Certifikaten per menaxhimin e cilesise se punimeve ISO 9001-2008***
- b. Certifikate per menaxhimin e mjedisit ISO 14001-2004***
- c. Certifikate per menaxhimin e shendetit dhe sigurimit ne pune OHSAS-18001***
- d. Certifikate per menaxhimin e sigurise rrugore ISO 39001 – 2012***
- e. Certifikate per system menaxherial te integruar Pas 99:2012***

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga bashkimi i operatorëve ekonomik dokumentet e paraqitura si mëposhtë :

***Certifikate per menaxhimin e sigurise rrugore ISO 39001 – 2012***

***Certifikate per system menaxherial te integruar Pas 99:2012***



Nga subjekti **Hastoçi shpk** nuk janë të vlefshme pasi aktiviteti i tyre nuk është objekt i prokurimit .

g.Në kriteret e veçanta të kualifikimit, **pika 2.4-5**,kapaciteti profesional kandidati /ofertuesi për sa i përket aftësisë profesionale duhet të dorëzojë dokumentet si më poshtë:

*Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë ( shtojca 9)*

Në kontratën e bashkëpunimit në preventivat e punimeve në zërin “Gërmime dheu me eskavator goma(me tryele 600-900 mm)0.15 m<sup>3</sup>,ne themele(gropa0.8x0.8x0.8x748),toke zak,kategoria III,me shkarkim ne toke”,ky zë punimesh është marrë përsipër nga subjekti **Hastoçi shpk**dhe nga ky subjekt sipas shtojcës 9 nuk ka deklaruar **Tryel për hapje Gropash**.

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga bashkimi i operatorëve ekonomik subjekti **Kajmaku Shpk**nuk ka paraqitur dokumentet si mëposhtë :

Makineri për shkulje pemësh,me thika 50-60 cm.

Makineria e paraqitur nga subjekti **Kajmaku Shpk**në bazë të faturës tatimore nr.1624,datë.22.06.2016 me permasa 60-70 cm nuk i plotëson kriteret e vendosura në **pikën 5** të dokumenteve standarte te tenderit.

Subjekti **Kajmaku Shpk** ka paraqitur ofertë individuale por një kohësisht rezulton edhe pjesëtar në bashkimin e operatorëve ekonomik **Kajmaku Shpk & Hastoçi shpk** .

Operatori ekonomik,pjesëtar i një bashkimi,nuk mund të paraqesë njëkohësisht dhe oferta individuale.Bashkimi i operatorëve ekonomik nuk ndryshon pas dorëzimit të ofertës,për këtë arsye oferta juaj **refuzohet**.Kjo në mbështetje të nenit 66 pika 4 e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,

Sa më sipër Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika3 dhe 5,të Ligjit Nr.9643,datë 20.11.2006,“Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII, Neni 66 pika 3, e shpall **të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

### 3.Operatori Ekonomik“KAJMAKU” shpk

Pas hapjes së ofertave, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se shoqëria “KAJMAKU” **shpk** nuk ka paraqitur në sistemin elektronik ofertën ekonomike si dhe kishte mungesë të plotë në të gjitha dokumentat ligjore, administrative, kualifikuese të përcaktuara në dokumentat e tenderit .

Mungesa e ofertës ekonomike dhe dokumentacionit u konfirmua nga të gjithë anëtarët e Komisionit te Vleresimit te Ofertave.

Subjekti “KAJMAKU” **shpk**është pjesëtar në bashkimin e operatorëve ekonomik **Kajmaku Shpk & Hastoçi shpk** .

Operatori ekonomik,pjesëtar i një bashkimi,nuk mund të paraqesë njëkohësisht dhe oferta individuale.Bashkimi i operatorëve ekonomik nuk ndryshon pas dorëzimit të ofertës,për këtë

arsye oferta e operatorit ekonomik “KAJMAKU” shpkrefuzohet.Kjo në mbështetje të nenit 66 pika 4 e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,

Sa më sipër Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika3 dhe 5,të Ligjit Nr.9643,datë 20.11.2006,“Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII, Neni 66 pika 3, e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **22 .07 .2016**

Ankesa: **PO**

Brenda afatit ligjor per paraqitjen e ankesave, u paraqitnjë ankesë si më poshtë vijon:

1.Bashkimi i operatorëve ekonomik **Kajmaku Shpk & Hastoçi shpk**,përfaqësuar me prokurë nga subjekti **Kajmaku shpk** me administrator**Znj.Merita Kajmaku**, është ankuar më datë**27/07/2016**mbi arsyet e skualifikimit të lart përmendura, pranë Bashkisë Kolonjë. Autoritetit Kontraktor i ka kthyer pergjigje me shkresen Nr.1986 date 04/08/2016 duke refuzuar ankesën.

Ky operator ekonomik nuk ka vazhduar me tej me shkallet e ankimimit, prane Komisionit te Prokurimit Publik (KPP).

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **operatorin ekonomik**Alb GardenSh.p.k****se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej/33 895 264(Tridhjetëtre milionet e tetë qind e nëntë dhjetë e pesë mijë e dy qind e gjashtë dhjetë katër) lekë pa Tvsh është identifikuar si oferta e **suksesshme**.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë

<b>Emri</b>	<b>Bashkisë Kolonjë</b>
<b>Adresa</b>	<b>Sheshi “ Rilindja ”</b>
<b>Tel/Fax</b>	<b>+355 812 2 2225 ; +355 812 2 3173</b>
<b>E-mail</b>	<b>bashkia.kolonje@gmail.com</b>

sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit,brenda **30(Tridhjetëditëve) ditëve** nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej *[vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

